

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2435/9 Prot.

Durrës, më 24.10.2025

V E N D I M

Nr. 121, datë 24.10. 2025

PËR

**"MIRATIMIN E FORMATIT TË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË
CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "GJUHË LETËRSI", TË FAKULTETIT TË
EDUKIMIT, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Udhëzimin Nr.10, datë 30.02.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 21.06.2022 dhe Udhëzimin Nr.19, datë 31.08.2023; në Urdhërin e MAS Nr. 358, datë 12.07.2023 "Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga Bachelor në "Gjuhë Letërsi Anglisht" në Bachelor në "Gjuhë Letërsi" në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; si dhe referuar relacionit Nr. 1161/3 prot., datë 21.10.2025 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 24.10.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formatit të diplomës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Gjuhë Letërsi", të Fakultetit të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t'i përcillet Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore i Fakultetit të Edukimit
 - Drejtorja e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

